



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborna komisija za žalbe i molbe

**A nr. 11/2009**

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me parashtresën e z. Tasim Bajrami, nga Piranë, Prizren, në seancën e mbajtur me 02. 11. 2009, mori:

**VENDIM**

Parashtresa refuzohet si e pabazuar.

**ARSYETIMI**

Z. Tasim Bajrami nga Prizreni, më datë 28.10.2009 ka parashtruar një parashtresë me të cilën pretendon se kandidatura e tij në listën e kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit prej listës së Partisë Social Demokrate të Kosovës (PSDK), është bërë pa vetëdijen dhe qëllimin e tij. Për më shumë, ai pohon se më datë 06.10.2009 përmes një njoftimi nga një shok ka kuptuar që është i angazhuar në listën e PSDKs-ë.

**FAKTET**

Më 28 Tetor 2009, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) ka pranuar një parashtresë nga Z. Tasim Bajrami nga Prizreni, me të cilën pretendon se Komisioni Qendror Zgjedhor duke u bazuar në rekomandimin e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim e ka refuzuar kërkesën e tij që të tërhiqet nga lista e kandidatit për zgjedhjet lokale nga PSDK për Kuvendin Komunal të Prizrenit, më datë 15.10.2009, me arsyetim se kërkesa e kandidatit në fjalë është paraqitur jashtë afatit ligjor, dhe nuk ka bazë ligjore për vendimmarrje.

Z. Bajrami kërkon nga KZAP që të merr parasysh kërkesën e tij, respektivisht që kandidatura e tij të tërhiqet nga lista e kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit, nga radhët e PSDK-së.

## ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Në bazë të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it, Neni 8.5, apelimet lidhur me certifikimin e listës së kandidatëve në bazë të nenit 26.6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-073), do të pranohet nga KZAP-i brenda pesë ditëve të punës pas njoftimit të atij subjekti politik me vendimin.

Neni 8.6 i kësaj Rregulle Zgjedhore specifikon se përveç nëse është saktësuar diku ndonjë afat tjetër, apelimi duhet dorëzohet brenda pesë ditëve nga njoftimi i KQZ-së.

Për më shumë, në Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, Neni 9.2 përcakton se KZAP-i mund t'i refuzoj apelimet që nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 8 të këtyre rregullave dhe procedurave apo që nuk i respektojnë dispozitat e duhura ligjore.

Meqenëse ankesa është dërguar në KZAP më 28.10.2009 dhe kandidati i PSDK-së për Kuvendin Komunal në Prizren ka pranuar vendimin e KQZ-së më 15.10.2009, kjo parashtrësë ka qenë e dërguar në KZAP përtej periudhës 5 ditore, siç specifikohet në Nenin 8.5 të Rregullave dhe Procedurave, prandaj refuzohet.

### Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësë në Prishtinë

A nr. 11/2009 më datën 02.11.2009

